

Imani dhe shtyllat e tij

الإيمان وأركانه

< Shqip – Albanian – ألباني >



Abdullah Ahmed El-Huvejl

عبد الله بن أحمد الحويل



Përktheu: Jusuf Kastrati

ترجمة: يوسف كاستراتي

IMANI DHE SHTYLLAT E TIJ

Përkufizimi gjuhësor i fjalës “Iman”:

Fjala *Iman* (الإيمان) gjuhësisht domethënë *vërtetim* dhe *pranim*.

Përkufizimi imanit sipas pasuesve të sunetit dhe xhematit është:

- a. besim me zemër,
- b. shqiptim me gjuhë,
- c. veprim me gjymtyrë,
- d. shtohet me bindje ndaj Zotit, dhe
- e. pakësohet me mëkatim ndaj Tij.

SHTYLLAT E IMANIT

Shtyllat e imanit janë gjashtë:

1. Besimi në Allahun.
2. Besimi në melekë.
3. Besimi në Librat e Allahut.
4. Besimi në të dërguarit e Allahut.
5. Besimi në Ditën e Gjykimit.
6. Besimi në kader (caktimin e Allahut).

1. Besimi në Allahun përfshin katër çështje:

- a. Besimi në ekzistimin e Allahut.
- b. Besimi se Ai është Zoti dhe Sunduesi.
- c. Besimi se vetëm Ai meriton adhurimin.
- d. Besimi në emrat dhe cilësitë e Tij.

2. Besimi në melekë përfshin katër çështje:

- a. Besimi në ekzistimin e melekëve.
- b. Besimi në melekët që i njohim me emra, sikurse Xhibrili, dhe besimi në mënyrë të përgjithshme në melekët që nuk ua dimë emrat.
- c. Besimi në cilësitë e tyre që i dimë.

d. Besimi në veprat e tyre që i dimë, të cilat i bëjnë me urdhrin e Allahut.

3. Besimi në Librat e zbritur përfshin katër çështje:

- a. Besimi se ata janë vërtet të zbritur nga Allahu.
- b. Besimi në emrat e librave që i njohim me emra, siç janë Kurani, Teurati dhe Inxhili.
- c. Besimi i tregimeve që thuhet në këta libra, sikurse tregimet e Kuranit dhe tregimet e pashtrembëruara të Librave të mëparshëm, të cilat janë përcjellë në sheriatin tonë.
- d. Besimi në normat e pashfuqizuara të këtyre Librave dhe po ashtu pajtimi me to dhe dorëzimi ndaj tyre, pa marrë parasysh a e dimë urtësinë a jo dhe besimi se Kurani ka shfuqizuar të gjithë Librat e mëparshëm.

4. Besimi në të dërguarit e Allahut përfshin katër çështje:

- a. Besimi se ata janë vërtet të dërguar nga Allahu dhe se kushdo që e mohon ndonjë të dërguar është sikur t'i mohonte të gjithë të dërguarit.
- b. Besimi me emra në ata të dërguar që përmenden me emra, siç janë: Muhamedi, Ibrahim, Musai, Isai, Nuhu e kështu me radhë (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ta).
- c. Besimi në lajmërimet e tyre autentike.
- d. Zbatimi i kushtetutës së pejgamberit të dërguar te ne, që është Muhamedi, vula e pejgamberëve, i cili është i dërguar te të gjithë njerëzit.

5. Besimi në Ditën e Gjykimit përfshin tri çështje:

- a. Besimi në ringjallje.
- b. Besimi në llogaridhënie dhe shpërblim.
- c. Besimi në Xhenet dhe Xhehenem.

Besimi në Ditën e Gjykimit përfshin gjithashtu besimin në çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes, ku bëjnë pjesë edhe sprovat e varrit dhe ndëshkimi e shpërblimi në varr.

6. Besimi në kader përfshin katër çështje:

- a. Besimi se Allahu e ka ditur çdo gjë në mënyrë të hollësishme.
- b. Besimi se Allahu e ka shkruar këtë në "Pllakën e Ruajtur" që në arabisht quhet "El-Leuh el-Mahfudh" (اللوحة المحفوظة).
- c. Besimi se asgjë nuk ekziston pa vullnetin e Allahut të Madhërishëm.

d. Besimi se çdo gjë që ekziston është krijuar nga Allahu, duke përfshirë qeniet, cilësitë dhe lëvizjet e tyre.

Argumenti për gjashtë shtyllat e imanit:

1. Thënia e Allahut:

﴿لَيْسَ الْبِرَّ أَنْ تُولُوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ﴾

﴿Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët.﴾¹

2. Gjithashtu edhe thënia e Allahut:

﴿إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ﴾

﴿Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me kader (masë të paracaktuar).﴾²

3. Argument nga suneti e kemi hadithin e Xhibrilit, kur e pyeti Xhibrili عليه السلام Pejgamberin ﷺ, duke thënë: "Më trego për imanin." Ai tha: "Imani është të besosh Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Gjykimit dhe të besosh se Allahu ka caktuar çdo gjë, qoftë e mirë a e keqe."³

¹ Sureja el-bekare, 177.

² Sureja el-kamer, 49.

³ Muslimi.

